



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO



Datë: 16.04.2025
Numër Protokolli: 2834/2025

A.nr.404/2025

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave në përbërje nga: Malsore Gashi-Bajraktari, kryetare, Eshref Shabani dhe Ardita Haxhnikaj Demi-anëtarë, me Atdhe Gashi, në cilësinë e procesmbajtësit, ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr.404/2025, të datës 03.03.2025, të parashtruar nga ankuesi A.Sh., kundër organit të punësimit/Shërbimit Korrektues të Kosovës, në çështjen juridike “*kompensim material*”, duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1, nenin 16 paragrafi 3 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.2 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr.08/L-180, dhe Rregulloren Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me datë 16.04.2025, mori këtë:

V E N D I M

I. APROVOHET si e bazuar ankesa numër A.nr.404/2025 e datës 03.03.2025 e parashtruar nga ankuesi A.Sh.

II. OBLIGOHET Drejtori i Përgjithshëm dhe Menaxheri i Burimeve Njerëzore në Shërbimin Korrektues të Kosovës, për zbatimin e këtij vendimi, në afatin prej 15 ditësh nga dita e pranimit të tij, ashtu që ankuesit ti bëjë kompensimin në vlerën e përgjithshme financiare prej 363.00 Euro, sipas Vendimit me numër protokolli 353, të datës 19.09.2024, të nxjerr nga Menaxheri i Burimeve Njerëzore i Shërbimit Korrektues të Kosovës.

III. Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës duhet të njoftohet me shkrim pas ndërmarrjes së veprimeve në pajtim me këtë vendim.

A r s y e t i m

Nëpunësit civil, A.Sh., (*në tekstin e mëtejme referuar: Ankuesi*), më datë 03.03.2025 ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, për shkak të mos zbatimit të vendimit me numër protokolli 335/2024 të datës 19.09.2024 të Menaxherit të Burimeve Njerëzore në Shërbimin Korrektues të Kosovës.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës (*në tekstin e mëtejme referuar: Këshilli*), bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me datë 17.03.2025 ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesën e ankuesve tek Shërbimi Korrektues i Kosovës, ndërsa ky i fundit më datë 19.03.2025 ka dërguar përgjigjen në ankesë së bashku me shkresat e bashkangjitura të lëndës. *Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave (në tekstin e mëtejme referuar: Kolegji i Këshillit) për vendosje meritore administroi këto prova:* Ankesën me numër protokolli 1378/2025 të datës 03.03.2025, të parashtruar nga ankuesi në Këshill; Kërkesën e datës 09.01.2025; Vendimin A.nr.1043/2024 të datë 27.08.2024; Dokument identifikimi i ankuesit; Vendimin A.nr.1165/2024 të datës 24.12.2024; Vendimin me numër protokolli 353 të datës 19.09.2024; Kërkesën për përgjigje në ankesë; Përgjigjen në ankesë të datës 19.03.2025; Kontratën e punës dhe përsëkrimin e detyrave të punës të ankuesit; Njoftimin përmes e-mailit të datës 01.11.2024; Vendimin me numër protokolli 1098 të datës 29.12.2023; Vendimin me numër 118 të datës 18.06.2019.

Kolegji i Këshillit, pasi që ka shqyrtuar të gjitha shkresat e lëndës të parashtruara nga palët në procedurë, konstatoi se ankesa e ankuesit është e **bazuar**, sepse:

Nga administrimi i shkresave të lëndës rezulton se ankuesi është i punësuar në Shërbimin Korrektues të Kosovës, gjegjësisht sipas Akt emërimit të datës 06.10.2003 i njëjti është punësuar në pozitën e punës *Oficer Sigurie*, ndërsa aktualisht sipas Kontratës së Punës të datës 30.06.2018, ankuesi është i punësuar në pozitën e punës *Zyrtar Korrektues* në Qendrën e Paraburgimit në Lipjan.

Si rrjedhojë, i njëjti përmes shkresës me numër protokolli 245 të datës 12.06.2024, kishte parashtruar kërkesë për kompensimin e pagës jubilarë tek Menaxheri i Burimeve Njerëzore i organit përkatës të punësimit, i cili përmes Vendimit me numër protokolli 335 të datës 19.09.2024, ka aprovuar kërkesën e ankuesit lidhur me kompensimin e pagës jubilarë dhe atë në vlerën e përgjithshme financiare prej 363.00 Euro.

Ankuesi, kundër mos ekzekutimit të pagës jubilarë sipas Vendimit me numër protokolli 335 të datës 19.09.2024, ka parashtruar ankesë në ankesën e parashtruar në Këshill, me kërkesën për aprovimin e ankesës dhe ekzekutimin e pagës jubilarë.

Kolegji i Këshillit në kuptim të shqyrtimit të pretendimeve ankimore të ankuesit, i' u referua dispozitave të Ligjit Nr.08/L-197 për Zyrtarët Publikë, përkatësisht nenit 6 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1, ku përcaktohet se : “1. *Nëpunësja/i civil me status të veçantë është nënkategori e nëpunëses/it civil, ku bëjnë pjesë: 1.1. të punësuarat/it e Shërbimit Korrektues dhe Sprovues të Kosovës*” paragrafi 2 nën

paragrafi 2.6 dhe 2.7, ku përcaktohet se : “2. Rregullimi me ligj të veçantë për nëpunësen/in civil me status të veçantë, sipas paragrafit 1. të këtij neni, duhet të jetë në pajtim me parimet e përcaktuara me këtë ligj dhe mund t'i rregullojë ndryshe vetëm elementet e marrëdhënies së punës, si në vijim: 2.6. përcaktimin e shkeljeve dhe masave disiplinore shtesë; 2.7. disiplinën dhe vlerësimi” si dhe nenit 3, ku përcaktohet se : “3. Ne rast të rregullimit me ligj të veçantë, për shërbyesin civil me status të veçantë - dispozita mbizotëruese janë dispozitat e ligjit të veçantë”.; si rrjedhojë e këtij përcaktimi ligjor ka analizuar edhe dispozitat e nenit 29, paragrafi 1, nën paragrafi 1.2, dhe 1.2.1, të Ligjit Nr.08/L-131 për Shërbimin Korrektues të Kosovës, ku përcaktohet se; 1. Përveç të Drejtave që janë të përcaktuara me Ligjin për Zyrtarët Publikë dhe Ligjit të Punës, personeli i SHKK-së ka edhe këto të drejta dhe detyrime specifike: 1.2. e drejta e pagës jubilarë: 1.2.1. personeli i SHKK-së gëzon të drejtën e një page jubilarë për çdo dhjetë (10) vite përvojë pune të pandërprerë në vlerë të një page bazë,; prandaj mbi bazën e këtij konstatimi ligjor, Kolegji i Këshillit konstaton se ankuesit i takon e drejta e kompensimit për shpërblim jubilar sepse sipas Vendimit me numër protokolli 335, të datës 19.09.2024, të Menaxherit të Burimeve Njerëzore në Shërbimit Korrektues të Kosovës, ankuesi me datën 16.09.2022 ka mbushur 20 vite përvojë pune.

Andaj, Kolegji i Këshillit, konstaton se Menaxheri i Burimeve Njerëzore i Shërbimit Korrektues të Kosovës, me rastin e nxjerrjes së Vendimit me numër protokolli 335, të datës 19.09.2024, përmes të cilit akt ka aprovuar ankuesit kërkesën për shpërblimin jubilar në vlerën e përgjithshme financiare prej 363.00, ka vërtetuar drejtë gjendjen faktike dhe bazën juridike, ndaj si rrjedhojë Kolegji i Këshillit, obligon Drejtorin e Përgjithshëm dhe Menaxherin e Burimeve Njerëzore në Shërbimin Korrektues të Kosovës, të ndërmarrë veprimet e përcaktuara sipas II të dispozitivit, ashtu që brenda afatit prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh nga dita e pranimit të këtij vendimi ti bëjë ankuesit kompensimin në vlerën e përgjithshme financiare prej 363.00 Euro.

Theksuar si më sipër, pas analizimit dhe vlerësimit të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar nënin 6 paragrafi 1, nën paragrafi 1.1 si dhe nënin 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.2 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr.08/L-180 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës Kolegji i Këshillit vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë–Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda me numër A.nr.404/2025

Atdhe GASHI

Procesmbajtës

Malsore GASHI-BAJRAKTARI

Kryetare e Kolegjit

Vendimi i dorëzohet:

- Ankuesit A.Sh.;
- Shërbimit Korrektues të Kosovës
(Drejtorit të Përgjithshëm dhe Menaxherit të Burimeve Njerëzore); si dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së